

## MBI LIGJËRIMIN FETAR NË GJUHËN SHQIPE

### I.

Terminologjia përbën një fushë specifike të leksikut në përgjithësi. Terminologjia është thelbi i stilit shkencor dhe është tipari më i spikatur i gjuhës së shkencës. Krijimi i termave është aq i lashtë sa vetë dija, por terminologjia si shkencë për termat është relativisht e re, i ka fillimet në periudhën ndërmjet dy luftrave botërore. Terminologjia shqipe, pas një periudhe të pashmangshme empirike, gjatë së cilës u grumbullua një përvojë e pasur për hartimin e fjalorëve terminologjikë, i hyri edhe përgjithësimi teorik të kësaj përvoje, edhe njohjes dhe zbatimit të standardeve terminologjike të sotme, në radhë të parë, të karakterit sistemor e hierarkik të terminologjisë.

Megjithatë, duhet vënë në dukje, sikundër është pohuar edhe në studime të tjera gjuhësore, se terminologjia shqipe ka mbetur ende në fazën e identifikimit dhe të shqipërimit të njërive terminologjike për çdo fushë të shkencës, të teknikës, të prodhimit e të kulturës, d.m.th. në fazën e standardizimit, me synimin që t'i shërbehet njësimi të saj e më tej ngulitjes në fushat përkatëse të veprimtarisë e më gjerë, pra normativizimit.<sup>(1)</sup>

Kjo gjë ndodh edhe me terminologjinë e fesë, kur kihet parasysh terminologjia fetare e të tri feve në gjuhën shqipe, që për shumë gjuhëtarë akoma ka hamendje si duhet trajtuar kjo fushë shumë specifike dhe e panjohur, sepse namazi dhe të gjitha lutjet e tjera bëhen në një gjuhë tjetër, në arabisht, lutjet e fesë së krishterë në latinisht (te katolikët) dhe në greqisht tek ortodoksët.

---

<sup>1</sup> J. Thomai, Fjala, termi dhe norma gjuhësore, Konferenca shkencore: "Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe - probleme dhe detyrë", Tiranë, 2009, f. 63-73.

Terminologjia fetare në gjuhën shqipe nuk mund të shënojë ndonjë avancim të theksuar, kur dihet se politika monoteiste shtetërore e kishte ndaluar rreptësisht praktikimin e fesë. Dhe, kuptohet që edhe njësimi i përgjithshëm i normës terminologjike fetare në shqip si në stilet e tjera të ligjërimit ka qenë i pamundur. Ligjërimit i specializuar fetar ka edhe specifikat e veta terminologjike, gjë që është shumë e natyrshme kur kihet parasysh terminologjia e Kuranit dhe e Biblës.

Ligjërimit fetar, sikurse pranohet nga shumë studiues, është më i hershmi dhe kronologjikisht vetë burimi i shqipes së shkruar, që vazhdon të trashëgojë probleme të pazgjidhura, që ngadalësojnë zhvillimin e tij si një stil i pavarur funksional i shqipes dhe pasuri e gjuhës së gjallë.<sup>(2)</sup>

## II.

Ligjërimit fetar në gjuhën shqipe, por edhe ligjërimit i specializuar (i fushave të ndryshme) ka hasur në vështirësi të cilat ka arritur deri diku t'i tejkalojë. Këtë e kanë përjetuar edhe gjuhët e mëdha, ose vazhdojnë t'i përjetojnë edhe sot si probleme të zhvillimit gjuhësor. Megjithatë, studimi i ndërveprimit gjuhësor dhe i fenomeneve fetare ka një traditë të pasur, përkundër vështirësive të theksuara që kanë pamundësuar një zhvillim të mirëfilltë të këtij leksiku. Në dy dekadat e fundit, leksiku terminologjik ka shënuar një zgjerim të fuqishëm, me diferencimin gjithnjë e më të theksuar të disiplinave shkencore, harmonizimin dhe standardizimin e terminologjisë nëpërmjet publikimeve, ose përkthimeve të shumta në gjuhën shqipe. Një nga problemet themelore në nivel teorik dhe metodologjik, i cili ka tërhequr vëmendjen e studiuesve është problemi i krijimit të leksikut kontrastiv, inventarizimit të tij, duke identifikuar strategjinë dhe drejtimit për zhvillimin e mëtejshëm të këtij leksiku.

Leksiku është komponenti më i rëndësishëm i organizimit të gjuhës së stileve në kuadër të kompleksit funksional të ligjërimit fetar, elementet e të cilit karakterizohen nga një semantikë

---

<sup>2</sup> Sh. Sinani, Ligjërimit fetar dhe gjuha shqipe, PERLA - Revistë shkencore - kulturore trimujore, Viti XI 2006, Nr. 3 (42), f. 69-8.

specifike, ngjyrim stilistik dhe dimension historik. Ky ligjërimit ka një orientim të theksuar ndërdisiplinor, që e bën të lidhet ngushtë me studimet e bëra mbi fenë, psikologjinë e fesë, sociologjinë e fesë, epistemologjinë teologjike, fetë krahasimtare etj.

### III.

Me këtë rast, duhet vënë në dukje lidhja midis dy disiplinave shumë të rëndësishme, ligjërimit të specializuar (ose ligjërimit fetar) dhe traduktologjisë (përkthimit), të cilat janë dy disiplina shkencore që përjetojnë zhvillimin e tyre të plotë në gjysmën e dytë dhe veçanërisht në fundin e shekullit të kaluar. Megjithëse secila prej tyre është një fushë e veçantë shkencore, ato janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Kjo lidhje rrjedh nga fakti që të dyja shkencat e studiojnë gjuhën, ndonëse në aspekte të ndryshme.

Kur flitet për marrëdhëniet midis këtyre dy disiplinave, në të shumtën e rasteve studiohen marrëdhëniet midis terminologjisë dhe përkthimit, përkatësisht kontributit të terminologjisë për përmirësimin e cilësisë së përkthimit. Një qasje e tillë mbështetet në faktin se terminologjia është zhvilluar më vonë si një fushë e veçantë shkencore dhe frytet e punës terminologjike ndihmojnë përkthyesit. Megjithatë, duhet të theksohet se këto marrëdhënie janë të dyanshme dhe përkthimi kontribuon në zhvillimin e terminologjisë.

Përkthimet e teksteve fetare dhe vetë Kuranit kanë ngjallur shumë debate, duke pasur parasysh shumëkuptimësinë e ligjërimit kuranor dhe pamundësinë e kthimit të tyre në një gjuhë tjetër (në këtë rast në gjuhën shqipe), duke vënë në dyshim aftësitë e gjuhës marrëse, në të cilën është përkthyer Libri i Shenjtë. Kjo vë në dukje karakterin psikologjiko-gjuhësor, përkatësisht kompetencën e kufizuar të arsyes njerëzore për interpretimin e Kuranit, por edhe të librave të tjerë në një gjuhë të caktuar. Sot, kemi përkthimin e Kuranit në shumë gjuhë të botës dhe në shumë versione, siç është bërë edhe në gjuhën shqipe, por akoma vazhdon të ngjallë diskutime nga shumë tefsirologë të shquar. Në gjuhën shqipe, përpjekjet e para në përkthimin e Kuranit, janë bërë nga Tahir efendi Gjakova (1835), i cili ka përkthyer dy sure: suren Ihlas dhe suren Asër. Pastaj, meritat për përkthimin e Kuranit i takojnë edhe Hafiz Ibrahim Dalliu. Por njeriu që botoi fragmentet e para shqip

të Kuranit, afro pesë shekuj pas përkthimit në frëngjisht, duke i vënë titullin “Këndim”, ishte një i krishterë, Ilo Mitkë Qafëzezi (1921), i cili pjesën e parë të përkthimit arriti ta bëjë në Rumani (1921), kurse pjesën e dytë në Korçë (1927). Përkthyesi me një qëllim të mirë thotë: “*Ti zgjidhim problemet tona nga librat hyjnorë. Ne nuk jemi rob të ndjenjave tona. Është një punë që duhet çmuar lart*”. Megjithatë, në aspektin gjuhësor, përmbajtësor, sikurse është vërejtur prej gjuhëtarëve, në këtë përkthim ka mjaft terma që lejojnë të kuptohet se shkalla e konvergencës terminologjike ndërftare mund të jetë më e madhe, si: shkrimet, libri, skriptura, terma që përdoren me një kuptim shumë të qartë, përkufizues, edhe në ligjërimin fetar të krishterë. Por kësaj konvergjence nuk i përgjigjet vijimisht sjellja gjuhësore ndaj termave të shkrimeve të shenjta dhe të liturgjisë e riteve gjejeje.<sup>(3)</sup> Poeti shqiptar, Naim Frashëri, në veprën e tij “Mësimet” (1894), në Bukuresht, boton një zë në vete të titulluar si “Thelbi i Kuranit”. Në ribotimin që bën “Rilindja”, pa kurrfarë arsyeje kjo pjesë është hequr.<sup>(4)</sup>

**Çdo punë e bërë duhet çmuar dhe duhet vlerësuar lart guximi i të gjithë atyre intelektualëve për të sjellë në gjuhën shqipe përkthimet e librave të shenjta. Meritë për këtë kanë edhe Salih Ferat Hoxha, Feti Mediu, Sherif Ahmeti, Hasan Nahi.**

Megjithatë, edhe në të gjitha këto përkthime, shkalla e mospërputhshmërisë së fjalisë krijon një paqartësi, sidomos për ata që nuk e njohin gjuhën arabe. Sa për ilustrim po analizojmë suren Nas.

Në përkthimin e Sali Ferhat Hoxhës është përkthyer: *Thuj: “Mbrohëm me Zotin e njerëzve, (1) Sundimtarin e njerëzve, (2) Perëndinë e njerëzve, (3) nga e keqja e pëshpëritjeve të djajve, (4) që pëshpërisin në zemrat e njerëzve (5) dhe janë prej xhindëve e njerëzve!” (6). Ndërsa, Feti Mediu e ka përkthyer kështu: Thuj: 1. “Mbështetem te Zoti i njerëzve, 2. Sundues i njerëzve, 3. Zoti i njerëzve, 4. Nga e keqja e djallit – mbrapshtanit, 5. I cili fut huti në zemrat e njerëzve, 6. Nga exhinët dhe njerëzit”. Sherif Ahmeti: Thuj: “Mbështetem (mbrohëm) me Zotin e njerëzve! Sunduesin e njerëzve, Të adhuruarin e njerëzve, Prej të keqes*

<sup>3</sup> Sh. Sinani, Ligjërimi fetar dhe gjuha shqipe, PERLA - Revistë shkencore - kulturore trimujore, Viti XI 2006, Nr. 3 (42), f. 69-8.

<sup>4</sup> Sh. Sinani, Ligjërimi fetar dhe gjuha shqipe, PERLA - Revistë shkencore - kulturore trimujore, Viti XI 2006, Nr. 3 (42), f. 69-8.

së cytësit që fshihet. I cili bën cytje në zemrat e njerëzve, Qoftë ai (cytësi) nga xhinët ose nga njerëzit". Hasan Nahi: Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve, nga shërri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt) e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve"!

Në të të gjitha versionet e përkthyer hasim në dallime, por nuk mund të thuhet se ka ndonjë ndryshim thelbësor që mund të merret si përkthim i gabuar. Por, mbi të gjitha duhet çmuar kontributi i dhënë nga të gjithë përkthyesit, të cilët kanë bërë një punë të madhe në shqipërimin e Kuranit.

### **Përfundime**

Në mbyllje mund të themi se qëllimi i këtij punimi ishte të hidhte një vështrim të përgjithshëm mbi ligjërimin fetar. Zhvillimi i shqipes si gjuhë funksionale në besim është pjesë e afirmimit të identitetit historiko-kulturor. Për të bërë një studim të mirëfilltë në fushën e studimeve të fesë nevojitet që shkrimet fetare të trajtohen mbi baza shkencore. Për zhvillimin sa më të denjë të gjuhës, për ta sjellë atë sa më afër gjuhës së popullit dhe për të shmangur sinoniminë e mbingarkuar terminologjike, nevojitet një bashkëpunim i ngushtë midis teologëve dhe gjuhëtarëve.

Ajo për të cilën ia vlen të tërheqim vëmendjen është përdorimi i të ashtuquajturave huazime edhe në gjuhën e fesë, që në fakt nuk janë gjë tjetër veçse mungesë kompetence gjuhësore nga ana e hartuesve të teksteve shkencore të kësaj fushe. Për këtë qëllim, do të sugjerohet që tekstet e fushave të ndryshme të fesë të kenë patjetër një redaktor gjuhësor, i cili mungon në pjesën dërrmuese të tyre. Një gjë e tillë do të ndihmonte jo vetëm për formimin e vetëdijes gjuhësore, por do të jetë edhe mbështetje për politikën gjuhësore dhe përkujdesjen ndaj gjuhës.

### **Bibliografia**

- Feti Mediu, *Ndikimi i literaturës fetare shqiptare në zhvillimet e terminologjisë fetare në gjuhën shqipe*, "Terminologjia fetare dhe gjuha shqipe", Tiranë, 2005.
- Halit Xhafa, *Drejtimi financiar ndërkombëtar*, Tiranë, 2001.